



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:050875

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05659968

PPP. nr. 1/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Artan Abazi me bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit M. Sh. nga, të cilin me autorizim e përfaqëson Burim Islami, avokat nga Gjilani, kundër debitorëve M. U.dhe H. U. nga duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të datës 24.01.2024, jashtë seancës gjyqësore, më datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i datës 24.01.2024 i debitorëve M. U. dhe H.U. nga, , i paraqitur kundër Urdhërit Përmbartimor P.nr.17/24 të datës 11.01.2024, të Përmbartuesit Privat Përparim I. Xhelili nga Gjilani.

II. Mbetet në fuqi Urdhërit Përmbartimor P.nr.17/24, i datës 11.01.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Përparim I. Xhelili nga Gjilani.

A r s y e t i m i

Përmbartuesi Privat Përparim I. Xhelili, ka lëshuar Urdhërin Përmbartimor P.nr.17/24, të datës 11.01.2024, sipas propozimit për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartues Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, C.nr.665/2020, i plotëfuqishëm me datë 10.11.2023, kundër debitorëve M. U. dhe H. U. nga, që të detyrohen të njëjtë që ta bëjnë kthimin në gjendjen e mëparshme në përputhje me pikën II dhe III të dispozitivit të Aktvendimit C.nr.665/2020, ashtu që të njëjtë bazuar në propozimin për përmbartim të obligohen që të largojnë vazot e betonit dhe rrethojnë e telit të vendosur mbi to, me një distancë prej 1.60 metra kah rruga kryesore, ndërsa në fund të parcelës me një distancë prej 1.45 metra në formë muri ndarës me një gjatësi prej 24.80 metra, duke e kthyer në gjendjen e para aktit të pengim posedimit sipërfaqen prej 39 m², të njësisë kadastrale me numër 01330-0 Zona

kadastrale Kamenicë, pjesë kjo e parcelës e cila gjendet dhe njlkohësisht në anën lindore kufizohet me parcelën me numër 1332-1, e cila në DGJKP në Kamenicë, evidentohet në emër të M. U., dhe të njëjtat veprime të njëjtit ti kryejnë vetë në të kundërtën kreditori të njëjtat do ti largoj dhe do ti kërkoj shpenzimet nga debitori.

Debitori pas pranimit të urdhërit përbarimor, në afat ligjor, më datë 24.01.2024 ka paraqitur prapësim me shkrim, me të cilin e ka kundërshtuar tërësisht këtë urdhër përbarimor, duke theksuar se Përbarimi është klasifikuar si proces juridik vlefshmëria e të cilit është i lidhur dhe varur nga zbatimi strikt i formave, duke theksuar kështu se nuk është respektuar forma e urdhërit përbarimore me të cilin është lejuar përbarimi rrjedhimisht nuk ka urdhër përbarues të vlefshëm, sepse nuk i është bashkangjitur urdhëri lidhur me lejimin e përbarimit si akt juridik i veçantë, tutje debitori përmes të autorizuarit të tij Besim Osmani, ka theksuar se debitori e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me datë 12.01.2023, ndërsa urdhëri përbarim është nxjerrë me datë 11.01.2024 andaj kemi të bëjmë me urdhër përbarimor të parakohshëm, tutje debitori përmes përfaqësuesit të tij ka theksuar se kanë paraqitur mjet të jashtëzakonshëm juridik dhe besojnë se Gjykata Supreme e Kosovës, do ti anuloj vendimet C.nr.665/2020 dhe Ac.nr.1529/2022 dhe çështjen do ta kthej në rivendosje. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të shfuqizojë urdhërin përbarimor në fjalë.

Kreditori përmes përfaqësuesit të tij avokatit Burim Islami, në përgjigjen në prapësim të datës 30.01.2024, ka theksuar se qendrimet e debitorit të paraqitura në prapsim nuk qëndrojnë dhe nuk paraqesin asnjë bazë ligjore për anulimin e Urdhërit për lejimin e përbarimit, e as nuk paraqesin asnjë bazë ligjore të parapara me dispozitat e LPP-së për shfuqizimin e Urdhërit për Përbarim P.nr.17/24, e aq më pak shtyerjen apo pezullimin e përbarimit pasi që ligji ka përcaktuar rastet në mënyrë decisive se kur mundë të veprohet në atë mënyrë, tutje ka theksuar se Urdhëri për lejimin e përbarimit është i bazuar në dokumentin përbarimior Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, me numër C.nr.665/2020 i datës 10.01.2022 dhe i plotëfuqishëm me datë 10.11.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 15.12.2023, dhe i njëjti është plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore të parapara me në LPP dhe si i till bazuar në nenin 22 par.1 pika 1.1 i LPK-së është dokument përbarues-titull ekzekutiv. Tutje ka theksuar se meqenëse përfaqësuesi i debitorit e ka përmendur faktin se ka paraqitur mjet të jashtëzakonshëm juridik, të njëjtin nuk ja ka bashkangjitur prapësimi eedhe pse i njëjti nuk do të kishte relevancë pasi i njëjti nuk e pezullon procedurën përbarimore, tutje ka theksuar se pasi që prapësimi i ushtruar nga ana e debitorit nuk gjen mbështetje në asnjërën nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPK-së në të cilat duhet të bazohet prapsimi i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapsimi i debitorëve dhe urdhëri përbarimor P.nr.17/24 i datës 11.01.2024 të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve vërtetoi se prapësimi i debitorit i datës 24.01.2024, është i pabazuar, pasi që i njëjti nuk ka vërtetuar asnjërën nga shkaqet që janë parapara në nenin 71 të LPP-së, përkatësisht i njëjti nuk është thirrur në asnjërën nga shkaqet për të cilat Ligji për Procedurën Përbarimore, ka përcaktuar se mund të paraqitet prapësim, përkatësisht pretendimi i përfaqësuesit të debitorëve se urdhëri

për përbarim është i pavlefshëm ngase ngase nuk i është bashkangjitur urdhëri për lejimin e përbarimit nuk gjen mbështetje, kjo ngase në nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përbarimore përcaktohet se *“Aktvendimi për përbarimin apo urdhri për përbarim nuk duhet ta ketë domosdo pjesën arsyetuese. Ky aktvendim apo urdhër mund të nxjerrët edhe duke u vënë vula katrore në propozimin për përbarim”* pra bazuar në dispozitën e cituar urdhëri për përbarim është i vlefshëm edhe nëse nxjerret duke u vënë vula katrore në propozimin për përbarim, siq edhe ka vepruar Përbaruesi Privat Përparim I.Xhelili në urdhërin përbarimore P.nr.17/24.

Lidhur me pretendimin tjetër se urdhëri për përbarim është i parakohshëm pasi që debitorët me datë 12.01.2023 e kanë pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit gjykata gjeti se një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi që një pretendim të tillë përfaqësuesi i debitorëve nuk e ka provuar me asnjë provë materiale të cilat do t’ia kishte bashkangjitur prapësimi po të ekzistonin, ndërsa në anën tjetër Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, me numër C.nr.665/2020, është lëshuar me datë 10.01.2022, është bërë i plotëfuqishëm me datë 10.11.2023, ndërsa Përbaruesi Privat ka lëshuar urdhër për përbarim në bazë të propozimit të kreditorit me datë 11.01.2024, andaj pretendimi se urdhëri i lartëcekur është i parakohshëm nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin nga përfaqësuesi i debitorëve se lidhur me Aktvendimin me numër C.nr.665/2020 dhe Ac.nr.1529/2022, ka paraqitur mjet të jashtëzakonshëm juridik, gjykata gjeti se i njejtë nuk i ka paraqitur provat me të cilat vërtetohet një fakt i tillë, mirëpo edhe po ta bënte një gjë të tillë, mjeti i jashtëzakonshëm juridik, nuk ka efekt suspenziv në raport me përbarueshmërinë e vendimit të formës së prerë, përkatësisht në nenin 213 të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcaktohet se *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përbarimin e aktgjykimin të formës së prerë të goditur”* . Andaj, në rastin konkret gjykata gjeti se Urdhëri Përbarimor i lëshuar nga Përbaruesi Privat Përparim I. Xhelili, në bazë të propozimit të debitorit, me numër 17/24 i datës 11.01.2024, është i drejtë dhe i ligjshëm dhe konform nenit 43 dhe 44 të Ligjit për Procedurën Përbarimore .

Nga arsyet e cekura më lartë, e konform nenit 5, 22, 27, 71 dhe 73 të LPP-së, gjykata vendosi si dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

PPP.1/2024, i datës 07.05.2024

**Gjyqtari,
Artan Abazi, d. v**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimet të këtij aktvendimi. Ankesa eventuale dorëzohet përmes kësaj gjykate.